



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 134, Datë 07.07.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“POWER ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET
PRODHUES 25 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/1 prot., datë 30.06.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “POWER ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1923 prot., datë 23.06.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Fshati Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar

më parë një licencë, se angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të ERE-s si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmës (a).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (a, b dhe e).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 310, datë 04.06.2025 *“Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale Nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “POWER ENERGY” sh.p.k.”*;
- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 5129 rep., nr. 2337 kol., datë 13.06.2025 *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 MW, dhe veprave ndihmëse, në Zonën Kadastrale 3038, Njësia Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “POWER ENERGY” shpk”*;
- Shoqëria është pajisur me VNM Paraprake, lëshuar më 17.02.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit *“Centrali fotovoltaike “Power Energy Solar” 25 MW”*.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

gërma “b”: Shoqëria duhet të depozitojë një letër të përditësuar të bankës, ku të shprehet vlera/përqindja me të cilën banka është aktualisht e interesuar të financojë këtë projekt, si dhe të dokumentojë disponimin e vlerës së mbetur nga vlera totale e projektit sipas kontratës me MIE-n.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “c”**: Shoqëria të depozitojë në ERE Miratimin Përfundimtar të pikës së lidhjes me OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 25 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “POWER ENERGY” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI